



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 7491/2025
Data: 09.09.2025

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e tetë - VIII- për vitin 2025 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 12.08.2025 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetarë i Komunës), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Bajrush Laçi** (Udhëheqës i Zyrës Ligjore), **Betim Dernjani** (Zyrtare e Personelit), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2025.
3. Planit Zhvillimorë Komunal.
4. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2024-2025.
5. Informatë për korrje shirjet.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATU RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:-përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Planit Zhvillimorë Komunal.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- me datë 31.07.2025 Ministria e Planifikimit Hapësinorë na e ka dhënë pëlqimin për miratimin e Planit Zhvillimorë pra dokumenti është i kompletuar në pajtim me planin Hapësinorë të Kosovës dhe i plotëson të gjitha kriteret e tjera të cilat janë të përcaktuara me Ligjin për Planifikim Hapësinorë të Republikës së Kosovës. Para se me najë dhënë pëlqimin për miratim, në muajin maj na e kanë dhënë pëlqimin për mbajtjen e debatit publik dhe e kemi organizuar edhe debatin publik, Kryetari i Komunës e ka formuar një komision për vlerësimin e kërkesave të qytetarëve dhe janë trajtuar të gjitha ato kërkesa, është hartuar raporti i shqyrtimit publik dhe dokumenti është dërguar në Ministrinë përkatëse për pëlqim final dhe pëlqimin e kemi siguruar tash është radha që Kuvendi Komunal ta miratoj.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI ZHVILLIMORË KOMUNAL QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2024-2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATI MBI SUKSESIN E ARRITUR TË NXËNËSVE NË SHFMU DHE SHML NË FUND TË GJYSMËVJETORIT TË DYTË TË VITIT SHKOLLOR 2024-2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Informatë për korrje shirjet.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abduraman Bushi thekson:- sa i përket korrje shirjeve ky vit ka qenë më i hershëm dhe po që se krahasohen sipërfaqet e mbjellurave në vitin 2022 kanë qenë 28 hektarë, ndërsa tani janë 57 hektarë pra është një dyfishim i sipërfaqeve të mbjellura të kulturave lavërtarë.

Sherif Berisha thekson:- është hapur procedura te Labi por sa është e kyçur komuna aty pra si është qasja e juaj si drejtor.

Abduraman Bushi thekson:- kemi bërë një projekt të përbashkët për me i ndihmuar fermerët , ne do të participojmë me 10 000 €, OJQ Labi 10 000 € por edhe pjesa që do të paguajnë fermerët. Planifikohen të ndahen 30 multikultivatorë. Është projekt i përbashkët që do të monitorohet nga dy palët.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATA PËR KORRJE SHIRJE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8. Të ndryshme.

Nuk pati diskutime

Kryesuesi thekson:-a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 11:30.

Procesmbajtësi
Avni Bushi

